**V E N D I M**
**Nr. 197, datë 9.5.2002**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR HEQJEN E VIZAVE PËR PASAPORTAT DIPLOMATIKE, TË SHËRBIMIT DHE ATO SPECIALE NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ARABE TË EGJIPTIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 dhe 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e Marrëveshjes për heqjen e vizave për pasaportat diplomatike, të shërbimit dhe ato speciale ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Arabe të Egjiptit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Pandeli Majko**

**MARRËVESHJE**
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ARABE TË EGJIPTIT MBI HEQJEN E VIZAVE PËR PASAPORTAT DIPLOMATIKE, TË SHËRBIMIT DHE SPECIALE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Arabe të Egjiptit,

Duke dëshiruar të lehtësojnë hyrjen, daljen dhe lëvizjen e shtetasve të tyre midis të dy vendeve,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Kjo Marrëveshje është e vlefshme për pasaportat e mëposhtme:

për Republikën e Shqipërisë – pasaportat diplomatike dhe të shërbimit;

për Republikën Arabe të Egjiptit – pasaportat diplomatike, të shërbimit dhe speciale.

Shtetasit e secilit vend, mbajtës të pasaportave diplomatike, speciale dhe të shërbimit, kanë të drejtë të hyjnë, dalin ose të kalojnë tranzit në territorin e shtetit tjetër pa viza.

Atyre u jepet, me të mbërritur, një leje qëndrimi prej 90 ditësh.

Neni 2

Anëtarët e misioneve diplomatike ose konsullore dhe të organizatave ndërkombëtare të akredituara në secilin vend, ashtu si edhe anëtarët e familjeve të tyre, mbajtës të pasaportave diplomatike, speciale dhe të shërbimit, kanë të drejtë të hyjnë në territorin e vendit tjetër pa vizë.

Neni 3

Hyrja dhe dalja e shtetasve të të dy vendeve, mbajtës të pasaportave diplomatike speciale dhe të shërbimit, në territorin e shtetit tjetër duhet të bëhen nëpërmjet pikave zyrtare të hyrjes të të dy vendeve.

Neni 4

Kjo Marrëveshje nuk i përjashton shtetasit e të dy vendeve, mbajtës të pasaportave diplomatike, shërbimit dhe speciale, nga detyrimet për të respektuar ligjet dhe rregullat në fuqi në territorin e vendit tjetër.

Nga ana tjetër, i jep secilit vend të drejtën për të refuzuar hyrjen dhe/ ose të anulojë qëndrimin e shtetasve të vendit tjetër drejt/në teritorin e tij nëse ata kryejnë akte që shkelin të tilla ligje dhe/ose rregulla.

Neni 5

Kjo Marrëveshje nuk ndikon mbi ligjet dhe/ ose rregullat e karakterit të përgjithshëm që janë në fuqi në të dy vendet në lidhje me sigurimin e brendshëm dhe atyre që organizojnë hyrjen, qëndrimin dhe lëvizjen e të huajve.

Neni 6

Palët do të shkëmbejnë, nëpërmjet kanaleve diplomatike, specimene të pasaportave diplomatike, speciale dhe të shërbimit.

Ato do të informojnë njëra-tjetrën për çdo ndryshim që do t'u ndodhë këtyre pasaportave, 60 ditë përpara hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve.

Neni 7

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën kur do të shkëmbehen notat diplomatike që tregojnë plotësimin e procedurave ligjore nga Palët përkatëse të kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje do të qëndrojë në fuqi përderisa asnjë nga Palët të mos informojë Palën tjetër me shkrim tre muaj paraprakisht për vendimin e saj për të përfunduar atë.

Bërë në Kajro, më 2.4.2002 në dy kopje origjinale në gjuhët shqip, arabisht dhe anglisht. Në rast mosmarrëveshjesh në interpretim do të vlejë teksti në anglisht.

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS ARABE TË EGJIPTIT